

Zhvillohet simpoziumi i EUROSAT mbi problematikat që shfaqen në institucionet publike me temë ‘Digjitalizimi i proceseve dhe qëndrueshmëria e institucioneve publike’

Në datat 30 dhe 31 Janar u zhvillua në Londër, simpoziumi i organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar si institucion anëtar i organizatës EUROSAT me temë ‘Digjitalizimi i proceseve dhe qëndrueshmëria e institucioneve publike’. Në këtë simpoziium morën pjesë drejtues dhe auditues nga rreth 30 institucione supreme auditimi, por edhe nga institucione të tjerë të sektorit publik në vende të ndryshme evropiane.

Çështjet e diskutuara në këtë simpoziium trajtuan disa prej problematikave dhe sfidave më të rëndësishme me të cilat përballen institucionet publike pothuajse në të gjithë vendet evropiane. Referuesit paraqitën për pjesëmarrësit eksperiencat e tyre të vlefshme lidhur me këto çështje ndër të cilat dy prej më kryesoreve dhe të diskutuara më gjerësisht ishin ‘digjitalizimi i proceseve’ dhe ‘qëndrueshmëria e institucioneve publike’.



Prezantimet e referuesve u vlerësuan tepër të përshtatshme dhe shërbyen si indikatorë për një ndërveprim në simpoziium thuajse të të gjithë pjesëmarrësve duke qenë se problematikat e diskutuara ishin në pjesën më të madhe të tyre të ngjashme dhe të prekshme për secilin prej vendeve, institucionet supreme të auditimit të të cilëve morën pjesë në këtë simpoziium.

Fokus të rëndësishëm në këtë simpoziium morën dhe diskutime të zhvilluara mbi rolin e ‘Drejtuesit të Menaxhimit të Riskut’ në institucionet publike, si një pozicion tepër i domosdoshëm dhe i rëndësishëm për të garantuar qëndrueshmërinë e institucioneve publike.

Perifrazimi kryesor i këtij simpoziumi ishte ‘Qëndrueshmëria është aftësia për t’u rimëkëmbur pas një goditjeje shkatërruese’, në mbështetje të së cilës drejtues të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar paraqitën për pjesëmarrësit shembullin e problematikave të konstatuara në lidhje me menaxhimin, administrimin dhe rimëkëmbjen nga situata e krizës së ndikuar nga pandemia Covid-19. Konkluzioni i këtij simpoziumi, i cili në vetvete mbarti perceptimin dhe linjën e të menduarit të të gjithë pjesëmarrësve përfaqësues të institucioneve supreme të auditimit ishte citimi se për të ndërtuar një sektor publik të qëndrueshëm duhet të jemi të përgatitur për t’u përballur dhe për t’iu përgjigjur situatave emergjente të cilat eksperiencia ka treguar se do të shfaqen patjetër në një moment të caktuar. Kontrolli i Lartë i Shtetit angazhoi për pjesëmarrjen në këtë simpoziium drejtues të teknologjisë së informacionit dhe auditues të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit.